



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës
Periudha raportuese	Shtator, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

- Gjatë muajit shtator 2020, janë realizuar shumë takime dhe aktivitete të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare, bazuar në planin e punës.
- Drejtoria e Kulturës dhe institucionet vartëse kanë realizuar planin operativ të punës, si dhe angazhime të tjera sipas nevojës.
- *Shënim (pjesa më e madhe e takimeve, qoftë me institucione apo individë, është mbajtur përmes platformës digjitale ZOOM për shkak të COVID -19, por edhe takime fizike sipas nevojës.)*

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

Sektori i Kulturës:

- Inicimi, koordinimi i aktiviteteve të prokurimit sipas planit të prokurimit dhe atij buxhetor;

- Planifikimi i takimeve me institucionet relevante lidhur me kulturën, trashëgiminë kulturore dhe promovimin e turizmit, ministritë relevante, organizata etj.;
- Përcjellja e punimeve gjatë implementimit të kontratës në Strehimoren e artit (Bregu i Diellit);
- Përgatitja dhe koordinimi i punëve për fillimin e implementimit të kontratës “Rivitalizimi i rrugës “Mehmet Kaçuri “” (rruga Model), është marrë leja në Drejtorinë e Urbanizmit, si dhe operatori ka dorëzuar planin dinamik;
- Përgatitja e projektdetyrës për ruajtjen, adaptimin dhe konservimin e ish-bibliotekës “Hivzi Sulejmani” në Galeri të Qytetit;
- Koordinimi i punëve rreth kërkesave dhe nevojave administrative dhe ligjore me drejtoritë përkatëse, Zyrën e prokurimit dhe Zyrën ligjore;
- Adresimi i kërkesave në shtab për dhënie të pëlqimeve për aktivitetet kulturore;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara;
- Përgatitja e raportit mujor;
- Takime me artistë për shkëmbimin e ideve rreth përpilimit të detyrës projektuese për adaptimin, ruajtjen dhe restaurimin e ish-bibliotekës “Hivzi Sulejmani” për Galeri të Qytetit;
- Takimet e vazhdueshme me përfaqësues të Manifestës;
- Koordinimi i punëve rreth kërkesave nga institucionet vartëse të Drejtorisë;
- Takimet me krijuesit e ueb-faqes për promovimin e turizmit “In Prishtina”;
- Lansimi i ueb-faqes për promovimin e turizmit “In Prishtina”;
- Monitorimi i aktiviteteve të subvencionuara nga Drejtoria;
- Hapja e thirrjes publike për subvencione, për fazën së dytë.

Arkivi Komunal:

- Rregullimi, klasifikimi dhe evidentimi e lëndës arkivore;
- Skenimi dhe digjitalizimi i disa projekteve të ndërtesave në Prishtinë.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Përgatitjet për festivalin “Ylberi i Prishtinës”.

TQP “Dodona”

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” për realizimin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme;
- Në rast të lejimit të punës së teatrove që janë ndaluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shkak të pandemisë, do të bëhen përgatitjet për sezonin e ri teator, si dhe do të bëhet realizimi i programit mujor të shfaqjeve në TEATRIN PËR FËMIJË dhe SKENËN E MBRËMJES, si dhe promovimi i tyre në rrjetet sociale.

Biblioteka “Hivzi Sulejmani”

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj, shërbimi me lexues, si dhe huazimi i librit;
- Përgatitja dhe planifikimi i programit të punës për vitin 2021;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Spektori i Kulturës:

- Vizitat në terren nga organi mbikëqyrës dhe zyrtarë të drejtorisë për implementimin e kontratës për vazhdimin e punimeve përfundimtare në Strehimore (Bregu i Diellit);
- Propozimi për organin mbikëqyrës pas nënshkrimit për aktivitetin “Furnizim me libra”;
- Mbikëqyrja dhe përcjellja e aktivitetit “Shërbimet konsulente” nga organi mbikëqyrës;
- Monitorimi dhe vazhdimi i zbatimit të aktivitetit “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore, në Arkivin e Prishtinës”;

- Takimi me artistë rreth ideve dhe përgatitja e detyrës projektuese për ish-bibliotekën “Hivzi Sulejmani”;
- Janë mbajtur takimet e rregullta virtuale më përfaqësuesit e Manifestës, si dhe përfundimi i procedurave bankare për pajisje me e-banking për “Manifesta 14” Prishtina;
- Përfundimi i punëve rreth vendosjes së veprës së Sislej Xhafës, si dhe realizimi i vendosjes së veprës dhe ceremonisë së inaugurimit;
- Hulumtim dhe përkthim për objektin e tulltores / Manifesta, si dhe dërgesa e raporteve të Manifestës për shpërndarje në institucione;
- Pjesëmarrje dhe koordinim i punëve me kabinetin lidhur me Muzeun lëvizës, në bashkëpunim me Unionin e Bashkive dhe Komunave Shqiptare në Rajon. Aktiviteti është mbajtur më 19 shtator, ku përfaqësuesit e Unionit janë mirëpritur nga nënkryetari dhe stafi i Komunës së Prishtinës;
- Punëtori njëditore e stafit të Drejtorisë së Kulturës në bibliotekën “Hivzi Sulejmani” në Taukbahçe, ku janë diskutuar të gjitha projektet, investimet kapitale, propozimet për iniciativat dhe idetë e reja të drejtorisë;
- Përpilim dhe adresim i kërkesave si: për vendosjen e biletarisë dhe depos së pajisjeve tek parku i aventurave, skeletit të kornizës strategjike për Termokiss, rreth lejes për parkun e aventurave, vendosjen e veprës së Sislej Xhafës, si dhe kërkesa tjera sipas nevojave të drejtorisë;
- Përgatitja e Marrëveshjes së bashkëfinancimit në mes Komunës Prishtinë, “Swisscontact” dhe “Sport – Marketing”;
- Koordinim rreth procedurave dhe punëve për gjetjen e hapësirave për akomodimin e zyrave për “Manifesta 14” ;
- Koordinim dhe takime me kompanitë për zhvillimin e ueb-faqes për promovimin e turizmit – “In Prishtina”, ku është diskutuar harta që duhet të dizajnohet, si dhe ueb-faqja promovuese e cila është në përfundim e sipër;
- Prezantimi i projekteve me arkitekt të NPB –së, te cilat janë ngarkuar nga drejtoria, ku gjatë prezantimit janë dhënë rekomandimet për plotësim të projekteve të cilat planifikohen të realizohen nga NPB;
- Adresimi për shtab i kërkesave për dhënie të pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore dhe shkarkimi nga intraneti, ku janë pranuar 20 lëndë të reja, duke përfshirë raporte narrative dhe financiare, kërkesa, pëlqime, vendime;
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara;

- Pjesëmarrje në panel me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Turizmit, më 27 shtator 2020, në hotel "Sirius", organizuar nga Unioni i Turizmit të Kosovës.

TQP "Dodona"

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ "Fondacioni për të drejtat e kafshëve" për realizimin e shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme;
- Përgatitja e propozimit për shfaqjet, thirrjen për subvencione për realizimin e shfaqjeve për TEATRIN PËR FËMIJË dhe SKENËN E MBRËMJES, për repertorin e TQP "Dodona", si dhe përgatitja e thirrjes në bashkëpunim me DK-në;
- Takimi i Këshillit drejtues të TQP "Dodona" ku, pos tjerash, është shqyrtuar dhe miratuar propozimi për thirrjen për subvencione për realizimin e shfaqjeve për repertorin e TQP "Dodona";
- Në bashkëpunim me DK-në, është bërë organizimi i takimit të Asociacionit të Teatrove Publike të Qyteteve të Kosovës (ATPQK) me drejtorët e drejtorive për kulturë dhe financa të komunave përkatëse që kanë teatro të qyteteve, për t'i shkëmbyer përvojat rreth modaliteteve të procedurave të financimit të prodhimit të shfaqjeve nga komunat. Për shkak të anulimit të pjesëmarrjes së shumë pjesëmarrësve për këtë takim, që ishte planifikuar të mbahej më 16 shtator, 2020, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, takimi është anuluar nga ATPQK;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

Biblioteka " Hivzi Sulejmani"

Për shkak të situatës me COVID -19, dhe mundësisë së përhapjes, me rekomandim të Drejtorisë së Kulturë të Komunës së Prishtinës, kemi punuar me staf reduktues sipas nevojës. Disa punë i kemi kryer online.

Më 29 .9. 2020, Kolegjiumi profesional së bashku me të gjithë punonjësit e bibliotekës, mbajti takim, ku drejtori informoi për vendimet e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Të gjithë së bashku shkëmbyem ide dhe mendime se si të fillojë puna me lexues, gjegjësisht se si të menaxhohet ambienti i bibliotekës në këtë periudhë pandemie.

Nga data 5.10.2020, puna filloi me orar të plotë, 8.00 - 19.00, duke respektuar të gjitha masat mbrojtëse të parapara nga ISHPK-ja.

Kryhen këto shërbime:

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj, huazimi i librit;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve mujore;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Organizimi i punëve me staf të reduktuar të QKF-së për shkak të pandemisë COVID -19;
- Përgatitjet për realizimin e festivalit “Ylberi i Prishtinës” - Edicioni i 18-të.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

- Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.

Spektori i Kulturës:

- o Vazhdimi i përgatitjeve komform protokollit të “Manifesta 14”, Bienale Evropiane e Artit Bashkëkohor;
- o Parapërgatitjet dhe koordinimi me organin mbikëqyrës dhe operatorin për fillimin e implementimit të aktivitetit “Rivitalizimi i rrugës “Mehmet Kaçuri”” (rrugës Model);
- o Vazhdimi i procedurave administrative, konkurs, “Projektimi për konservimin dhe adaptimin e shtëpisë-shkollë në Muzeun e shtëpive shkolla, (Lagja e Herticëve, Prishtinë);
- o Ndërtimi i qendrës kulturore për të rinj - Bibliotekës në lagjen “Kodra e Trimave, në fazën e formimit të organit mbikëqyrës;
- o Rregullimi i ambientit për ekspozimin e veprave të artit, janë duke u zhvilluar punimet, punimet janë në përfundim e sipër;
- o Aktiviteti “Furnizim me libra” në muajin tetor pritet të fillojë zbatimin i kontratës;
- o Fillimi i zbatimit të kontratës për aktivitetin “Furnizimi dhe montimi i pajisjeve për ngritjen e sigurisë së lëndës arkivore në Arkivin Komunal të Prishtinës;

- Renovimi i bibliotekës “Hivzi Sulejmani”, degës “Përkujtimorja” në Taukbahçe, në fazën e formimit të organit mbikëqyrës;
- Projektdetyra për Galerinë e Qytetit, finalizimi i detyrës projektuese;
- Koordinimi i punëve rreth procedurave administrative për fillimin e zbatimit të Parkut të aventurave.

Arkivi Komunal

Rregullimi i materialit arkivorë, fondi Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Pronës;

Skenimi dhe digjitalizimi i objekteve të ndryshme në Komunën e Prishtinës.

Qendra Kulturore e Fëmijëve

- Përgatitja dhe xhirimi i sektorit të valleve për pjesëmarrje në festivalin “Damestion –Kosovë”;
- Përgatitje për festivalin “Ylberi i Prishtinës 2020 ”;
- Ftesa për pjesëmarrës në festivalin “Ylberi i Prishtinës”;
- Kontakte dhe informata me shtetet pjesëmarrëse;
- Takime për realizimin e festivalit;
- Xhirime për hapjen e festivalit.

Biblioteka e qytetit “Hivzi Sulejmani”

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Shërbime me lexues;
- Përgatitja e raporteve;
- Mirëmbajtja e ueb-faqes së bibliotekës.

TQP “Dodona”

- Komunikimi me organizatën partnere OJQ “Fondacioni për të drejtat e kafshëve” për realizimin e shfaqjes për fëmijë “Teo, qeni i rrugës”, i cili ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

4.1.3 Takimet me palë

Sektori i Kulturës:

- Takime virtuale me përfaqësuesit e Termokissit;
- Takime të shpeshta me Rozafa Imamin dhe Sislej Xhafën për përfundimin e punimeve para vendosjes së veprës;
- Takim me kryeshefin e Stacionit të Autobusëve, z. Luan Hoti, dhe zyrtarin ligjor Agron Sejdiu;
- Takim virtual me Malva Govornin dhe Donika Gashin;
- Takime me palë, duke dhënë rekomandime bazuar në kërkesat, shqetësimet e tyre rreth subvencioneve, pëlqimeve, udhëzime sipas nevojave të palëve.

5. Takimet me institucione të tjera

- Drejtorja e DK-së, Blerta Basholli, dhe Drejtori i TQP “Dodona”, Visar Krusha, janë takuar në Gjilan me drejtoreshën e DKRS në Gjilan, Deniza Limani, dhe drejtorin e Teatrit të Qytetit të Gjilanit, Erson Zymberi, për t’i shkëmbyer përvojat rreth modaliteteve të procedurave të financimit të prodhimit të shfaqjeve, pasi tashmë Komuna e Gjilanit është duke e praktikuar një modalitet, ku Kryetari i Komunës e miraton listën e kontratave për shërbime të veçanta për bashkëpunëtorët e jashtëm që angazhohen nga Teatri, pas miratimit të kësaj liste nga Këshilli drejtues i Teatrit të Qytetit;
- Takime me zyrtarë të NPB-së për paramasat e institucioneve vartëse kulturore;
- Takime të shumta me artistë të ndryshëm për adaptimin e ish-ndërtesës së bibliotekës “Hivzi Sulejmani”;
- Takime konsultative me Swisscontact;
- Korrespondenca me KoreenSports;
- Bashkëpunimi mes Komunës së Prishtinës dhe kolegjit “Dardania” për mundësinë e bashkëpunimit në fushën e tuizmit;
- Takim virtual me përfaqësues të Ambasadës austriake rreth projekteve kulturore.

Arkivi Komunal:

- Më 28.09.2020, takim me përfaqësuesit e Komunës së Prizrenit në lidhje me marrëveshjen e bashkëpunimit, me theks të veçantë për mundësinë e krijimit të një katalogu të ngjashëm, sikurse e ka bërë Arkivi Komunal i Prishtinës.

6. Diskutime publike / takimet me qytetarë

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Arkivi Komunal:

Gjatë muajit shtator 2020, kemi pasur gjithsej 38 kërkesa, të cilave iu kemi përgjigjur brenda afatit ligjor.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

7. Takime të tjera

- 8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Arkivi Komunal:

Gjatë implementimit të planit po hasim në vështirësi të mëdha si pasojë e pandemisë COVID -19, si dhe mungesës së stafit, sidomos në shërbimin e rregullimit të lëndës arkivore. Andaj, ne si Arkiv Komunal duhet përmendur faktin se kemi nevojë për së paku 3 punëtorë/e.

- 9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.**

Biblioteka "Hivzi Sulejmani"

- Të rekrutohen punëtorë të rinj;
- Të shtohen 150 tavolina dhe 150 karrige;
- Renovimi i tualeteve;

- Zgjidhja e problemit me rrymë dhe vendosja e dritave të neonit në objektin e ri;
- Renovimi i objektit në degën “Pallati i Rinisë”;
- Renovimi i objektit në degën “Përrallat” dhe “Lektyra”.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Sektori i Kulturës

- Vlerësimi i projekteve të arritura nga komisioni, të thirrjes publike për fazën e dytë dhe thirrjes për teatrin “Dodona”;
- Përcjellja e të gjitha aktiviteteve të iniciuara nga Drejtoria, të cilat janë në implementim me kontrata të hapura, si dhe ato të cilat fillojnë implementimin, kontaktet e vazhdueshme dhe koordinim i punëve me organet mbikëqyrëse, duke përfshirë edhe vizitat në terren rreth implementimit;
- Inicimi i proceduarve të reja të prokurimit bazuar në planin e punës së drejtorisë;
- Monitorimi i punës së institucioneve vartëse;
- Shqyrtimi i lëndëve dhe kërkesave;
- Vazhdimi i përgatitjeve, koordinimi i punëve konform protokollit të “Manifesta 14” dhe Komunës së Prishtinës, Bienale Evropiane e Artit Bashkëkohor;
- Vazhdimi i koordinimit të punëve rreth rihapjen së Zyrës informative turistike, si dhe diskutimet për hapjen e pikës së re që planifikohet në Stacionin e Autobusëve.

Arkivi Komunal:

- Vazhdimi i rregullimit të fondit të Komunës së Prishtinës, Drejtoria e Pronës.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Organizimi i festivalit “Ylberi i Prishtinës 2020”, i cili planifikohet të mbahet më 17 tetor.

TQP "Dodona"

- Realizimi i shfaqjeve të rregullta në TEATRIN PËR FËMIJË, të shtunën, prej orës 12:00 dhe të dielën prej orës 12:00: " "Mik-mik" (PREMIRË), "Fjalët magjike", "Liza në botën e çudirave" dhe "Mustaqoshi larosh";
- Realizimi i shfaqjes mysafire "Unë jam vetë grua" në SKENËN E MBRËMJES, që do të jetë pjesë e festivalit "Kosovo Showcase 2020";
- Komunikimi me organizatën partnere OJQ "Fondacioni për të drejtat e kafshëve" për realizimin e shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", që ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Fillimi i provave të shfaqjes për fëmijë "Teo, qeni i rrugës", në koproduksion me OJQ "Fondacioni për të drejtat e kafshëve", që ka fituar subvencion nga Komuna e Prishtinës;
- Promovimi i programit mujor dhe i shfaqjeve në rrjetet sociale;
- Komunikimi me donatorët potencialë dhe palë të ndryshme.

Biblioteka "Hivzi Sulejmani"

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare;
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj;
- Huazimi i librit;
- Përgatitja e raporteve mujore.

11. TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

Arkivi Komunal:

- Arkivi Komunal gjatë këtij muaj ka përcjellë punët në zbatimin e projektit për sigurinë e lëndës arkivore.